



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 421 Prot.

Tiranë, më datë 11 . 07 2025

VENDIM

Nr. 382, datë 11.07.2025

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të kërkesës në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 11.07.2025:

VENDOSI

1. Miratimin e kërkesës së **Z. Johan Koroveshi** për pajisje me Licencë individuale në Projektim (P), në veprimtari ndërhyrëse në pasuri kulturore materiale në kategorinë (A): në nënkategoritë P/A/3, P/A/5, P/A/7;
2. Mosmiratimin e kërkesës së **Z. Johan Koroveshi** për pajisje me Licencë individuale në Projektim (P), në veprimtari ndërhyrëse në pasuri kulturore materiale në kategorinë (A): P/A/1, P/V/2, P/A/4, P/A/6 pasi nuk plotëson numrin e projekteve në këtë nënkategori, sipas përcaktimeve të VKM nr.792/2020, Kreu II/B, pika 1, gërma c;
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
4. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Joli MITROJORGJI



KRYETAR
Blendi GONXHJA